

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR ME OBJEKT “AUDITIMI I
LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE” PËR PERIUDHËN
01.01.2013 – 31.12.2014.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, me objekt “Auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën 01.01.2013 deri në 31.12.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 122, datë 21.09.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 3357, datë 21.09.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar znj. Etleva Bisha Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

**A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË
LEGJISLACIONIN NË FUQI.**

-Programi vjetor i kontroleve për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar hartohet bazuar VKM-së nr. 512, datë 31.5.2006 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore” i ndryshuar dhe Rregullores së Brendshme.

Veprimtaria SHSSH dhe masat e rekomanduara për përmirësimin e gjendjes së konstatuar nga kontrollet e ushtruara, kryesisht bazohet në VKM-në nr. 512, datë 31.5.2006 i ndryshuar. Me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 25/2013 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, janë krijuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar, duke zëvendësuar në këtë mënyrë Inspektoratin. Kjo strukturë dhe pse ka zëvendësuar Inspektoratin, e zhvillon veprimtarinë e vet bazuar në të njëjtin akt nënligjor që rregullonte veprimtarinë e Inspektoratit dhe konkretisht në VKM-në nr. 512, datë 31.5.2006 me ndryshime. Akti nënligjor në fjalë, nuk ka pësuar ndryshimet e nevojshme në përputhje me ndryshimet e njëpasnjëshme që i janë bërë ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005. Për pasojë kemi një “hendek” mes ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, i cili krijon domosdoshmërinë për ndryshime përkatëse në VKM nr. 512, datë 31.5.2006 me ndryshime.

-Nisur nga problematikat e konstatuara në vitin 2013 dhe të mbartura në vite, familjet e trajtuara me NE nuk mund të jenë pjesë e trajtimit në skemë për kohë të pacaktuar (gjithë jetën), fenomen që favorizon informalitetin dhe rrit koston në buxhet. Nuk është evidentuar përpjekja për përmirësime ligjore në lidhje me afatet për Ndihmën Ekonomike dhe PAK.

Për këtë është rekomanduar:

-SHSSH të iniciojë dhe kërkojë përmirësimet e nevojshme në VKM nr. 512, datë 31.5.2006 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore” i ndryshuar, duke reflektuar ndryshimet e njëpasnjëshme të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 me ndryshime, për tu përshtatur strukturave të krijuara përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar.

Gjithashtu të iniciojë dhe kërkojë përmirësimet e nevojshme ligjore lidhur me:

-skemën e përfitimit të NE dhe PAK, duke konsideruar faktorët e riskut dhe mekanizmat ligjor për reduktimin e tyre me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve buxhetore me karakter social.

-rishikimin e strukturës dhe organikës së njësive të kontrollit të ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuar në mënyrë të tillë që të gjitha dosjet t'i nënshtrohen kontrollit në kohë reale.

-identifikimin e personave pjesë e skemës së NE, të cilët konsiderohen potencial për t'u angazhuar në punët publike në ndihmë të komunitetit.

-bashkërendimin e punës midis zyrave lokale të punës me administratorët socialë lokalë me qëllim krijimin e mundësive të punësimit për personat e aftë për punë në mënyrë që të lehtësohet skema dhe të reduktohen kostot.

Në vijimësi

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i dokumenteve mbi zbatimin e kontratave, janë konstatuar shkelje, lidhur me furnizimin me mallra e shërbime, jo sipas kërkesave e specifikimeve teknike. Një nga shkaqet kryesore për mosfurnizimin e mallit apo shërbimit të kërkuar është mosrealizimi i mbikëqyrjes së kontratës (*Trajtuar më hollësisht në faqet 34-53 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë është rekomanduar:

Me nënshkrimin e kontratës për mallra, punë apo shërbime, autoriteti kontraktor të emërojë personin apo grupin që do të monitorojë zbatimin e kontratës, të përgatitet raporti përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të saj.

Në vijimësi

2. Shërbimi Social Shtetëror si dhe Drejtoritë Rajonale, në zbatim të nenit 26/2 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 i ndryshuar "*Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore*", kanë bërë vetëm evidentimin e efekteve financiare me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe në zbatim të VKM nr. 512, datë 31.5.2006 "*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore*", kanë rekomanduar masa disiplinore/gjopa apo kallëzim penal për personat përgjegjës.

Për të gjitha rastet e konstatuara "*dëm ekonomik*" nga veprimet abuzive të personave përgjegjës, duke përjashtuar ato kur dëmi ekonomik ka ardhur si pasojë e llogaritjeve të gabuara për NE dhe PAK-së, nuk rezulton në asnjë rast që SHSSH, Drejtoritë Rajonale të kenë kërkuar referuar nenit 41/2, c të këtij ligji me padi civile "*shpërblimin e dëmit*", sipas nenit 608 të Kodit Civil. Kjo ka sjellë si pasojë, që dëmi shkaktuar buxhetit të shtetit vetëm të evidentohet si fenomen dhe jo të kërkohej kthimi i tij, duke e trajtuar si dëm të pakthyeshëm, i cili vjen gjithnjë duke u rritur.

Mungesa e dhënies së rekomandimit për kërkimin e dëmit ekonomik në rrugë gjyqësore sipas nenit 608 të Kodit Civil, ka sjellë si pasojë që vetëm për periudhën e audituar tetor-dhjetor 2013, dëmi i evidentuar vetëm për 116 njësi të kontrolluara nga SHSSH, të jetë në vlerën **37,894,667** lekë, për vitin 2014, në njësitë e kontrolluara nga SHSSH dëmi ekonomik i evidentuar është në vlerën **10,390,460** lekë, ndërsa në 348 njësitë e kontrolluara nga Drejtoritë Rajonale arrin në vlerën **61,299,550** lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 34-53 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë është rekomanduar:

Të merren masa nga SHSSH, që në të gjitha rastet e evidentimit të “*dëmit ekonomik*” shkaktuar nga veprimet abuzive, të kërkohet në rrugë gjyqësore dhe kthimi i tij në buxhetin e shtetit, bazuar në nenin 41/2,c të ligjit nr. 9355 datë 10.03.2005 i ndryshuar “*Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore*” dhe nenin 608 Kodit Civil, në mënyrë që dëmi ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit, të vijë duke u minimizuar si pasojë e arkëtimit të tij nga personat përgjegjës.

Menjëherë

3. Nga Njësia e Auditit të Brendshëm (NJAB) në programet vjetore të auditimeve për vitet 2013, 2014, miratuar me shkresën nr. 1164/1, datë 14.10.2013, nuk janë parashikuar auditimi i Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH, Drejtorisë së Kontrollit të Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar, për vlerësimin e sistemit të brendshëm të kontrollit dhe nëse kjo drejtori ka realizuar objektivat e saj në zbatim të nenit 26/2 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “*Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore*” (Trajtuar më hollësisht në faqet 67-78 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë është rekomanduar:

Në programet vjetore të auditimeve NJAB, të parashikojë auditimin e Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH, Drejtorisë së Kontrollit të Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar, për të vlerësuar sistemin e brendshëm të kontrollit dhe realizimin e objektivave të tyre për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.

Në vijimësi

4. Të dhënat statistikore të grumbulluara nga bashkitë/komunat të cilat vlerësohen, përpunohen dhe standardizohen nga Drejtoritë Rajonale dhe dërgohen në SHSSH, në disa prej treguesve përsëriten në disa formularë, duke krijuar vështirësi në hedhjen e tyre apo dhe gabime në mbartje të të dhënave, pasi nuk ka një unifikim të evidencave statistikore. (Trajtuar më hollësisht në faqet 67-78 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë është rekomanduar:

Të bëhet unifikimi i evidencave për të mundësuar vlerësimin, përpunimin dhe standardizimin e të dhënave statistikore nga Drejtoritë Rajonale dhe SHSSH, për të evituar përsëritjen e treguesve në disa formularë, me qëllim hedhjen dhe mbartjen e të dhënave pa gabime në përputhje me VKM nr. 617, datë 7.9.2006 “*Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe të shërbimeve shoqërore*”

Menjëherë

5. Nga auditimi konstatohet se Sektorët e Statistikës dhe Buxhetit në vartësi të Drejtorisë së Financës nuk rakordojnë të dhënat faktike me të dhënat e planit, duke sjellë që programimi dhe përdorimi i fondeve buxhetore për ndihmën ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror të mos jetë efektiv. (Trajtuar më hollësisht në faqet 67-78 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë është rekomanduar:

Drejtoria e Financave të marrë masat që Sektori i Statistikës dhe Sektori i Buxhetit të bashkëpunojnë mes tyre për rakordimin e të dhënave faktike me të dhënat e planit, në mënyrë që programimi dhe përdorimi i fondeve buxhetore për ndihmën ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror të jetë më efektiv dhe eficient.

Në vijimësi

6. Nga auditimi i praktikave për likuidimin e NE dhe PAK-ut në Komunën Portëz-Fier rezulton se likuidimi i tyre për vitin 2014, është bërë pa u marrë më parë vendimi i Këshillit të Komunës, referuar kjo kronologjisë së vendimeve të Këshillit të Komunës, veprim i cili bie në kundërshtim me ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 i ndryshuar, neni 20/1 dhe 29,

Udhëzimin nr. 338/3, datë 10.03.2006 i ndryshuar, kreu XI, pika 7, sipas të cilës “*Borderoja do të ketë vendimin bashkangjitur...*”. Gjithashtu rezulton se borderotë nuk kishin të bashkangjitur vendimin e Këshillit të Komunës, pasi ai nuk është mbledhur çdo muaj sipas kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 8652 datë 31.7.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, i ndryshuar, kreu VI, neni 31/2 dhe për pasojë janë kryer pagesa pa patur më parë vendim të Këshillit Komunal (vendimet kanë dalë brenda 4 mujorit) për aftësinë e kufizuar dhe invalidë në vlerën **34,998,025 lekë**, duke krijuar një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit (Trajtuar më hollësisht në faqet 67-78 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë është rekomanduar:

Të merren masa që likuidimi i pagesave për aftësinë e kufizuar dhe invalidë të shoqërohen me vendimet përkatëse të Këshillave Bashkiak, në përputhje me ligjin për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore.

Në vijimësi

7. Nga auditimi u konstatua se Këshilli Administrativ për vitin 2013 nuk ka realizuar asnjë mbledhje, në kundërshtim të plotë me rregulloren dhe VKM nr. 542, datë 27.07.2005 “*Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror, i ndryshuar, neni 10, Këshilli Administrativ i Shërbimit Social Shtetëror*”. Për vitin 2014 rezulton, një mbledhje e KA ku është miratuar rregullorja e KA e cila në pikën 1 të saj e përcakton qartë se KA duhet të mbledhet minimalisht 4 herë në vit me qëllim përmbushjen e kompetencave të parashikuara në pikën 3 të rregullores për Këshillin Administrativ. Në rregullore përcaktohet se: Këshilli Administrativ ***shqyrton studime në fushën e ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuar, propozon përmirësime në politika dhe në legjislacionin e shërbimeve shoqërore. Nuk kemi evidentuar në asnjë rast shqyrtimin e mundësive për përmirësime ligjore në lidhje me Ndihmën Ekonomike dhe PAK, nisur nga problematikat e konstatuara në vitin 2013 dhe të mbartur në vite; familjet e trajtuara me NE nuk mund të jenë pjesë e trajtimit në skemë për kohë të pacaktuar (gjithë jetën), pasi ky fenomen nxit informalitetin (punën e zezë) dhe rrit koston në buxhet (Trajtuar më hollësisht në faqet 65-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).***

Për këtë është rekomanduar:

Në mënyrë që Këshilli Administrativ të kryej detyrat e tij funksionale është me rëndësi të vlerësohet ristrukturimi i Këshillit Administrativ me pjesëmarrës palë të interesit dhe dominancë të shoqërisë civile për vetë rëndësinë sociale dhe publike që kanë shërbimet shoqërore në kontekstin publik.

Në vijimësi

8. Strukturat drejtuese në Drejtoritë Rajonale jo vetëm janë të limituara në numër, por u konstatua se në të gjitha drejtoritë prej një viti ka pozicione vakante për shkak të procedurave të vonuara nga DAP, i cili administron plotësimin e strukturave në institucionet vartëse të SHSSH dhe drejtorinë e përgjithshme. (Trajtuar më hollësisht në faqet 65-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë është rekomanduar:

SHSSH të komunikojë me strukturat e Departamenti të Administratës së Lartë Publike për plotësimin e vendeve vakante në strukturat rajonale të SHSSH, duke theksuar koston e lartë institucionale që sjell vonesa në procedurat e punësimit nga DAP.

Në vijimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

-Nga auditimi me zgjedhje në njësitë e varësisë së SHSSH dhe konkretisht në Drejtorinë Rajonale Fier, u krye verifikimi mbi shpërndarjen e fondeve të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar në njësinë administrative Komuna Portëz –Fier ku konstatohet se për vitin 2014, pagesa e aftësisë së kufizuar, nga Sektori i Financës është kryer mbi bazën e borderove të paraqitura nga Administratori Social dhe jo mbi bazën e vendimeve të Këshillit të Komunës. Në këtë mënyrë, praktikës së likuidimit nuk i bashkëngjitej Vendimi i Këshillit të Komunës me numrin e personave përfitues dhe fondin e miratuar. Për pasojë, nga Sektori i Financës janë kryer likuidime për PAK-së në vlerën **665,950 lekë**, më shumë se fondi i miratuar me vendim të Këshillit të Komunës me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit duke vepruar në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, Kreu III, pika 35/b (Trajtuar më hollësisht në faqet 67-78 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”* neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 *“Kodi i Procedurës administrative”* pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, Kapitulli IV *“Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve”* pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, në vlerën **665,950 lekë**, nga z. A.SH, ish Kryetar i Komunës Portëz-Fier në cilësinë e urdhëruesit të kryerjes së shpenzimit dhe z. T.K., në cilësinë e Kontabilistit dhe Nëpunësit Zbatues në këtë komunë pasi janë kryer likuidime për PAK-së në vlerën 665,950 lekë, më shumë se fondi i miratuar me vendim të Këshillit të Komunës me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

Menjëherë

-Për muajin Dhjetor 2014, në Komunën Portëz-Fier, nga 50 familje përfituese të ndihmës ekonomike të propozuara në Projektvendim nga Administratori Shoqëror, janë futur për miratim nga ana e Këshillit të Komunës dhe 3 familje më shumë, trajtuar jashtë kriterëve, me një fond total **9,000 lekë**, duke rritur në këtë mënyrë numrin e familjeve në NE nga 50 në 53 familje. Futja në skemën e ndihmës ekonomike të këtyre familjeve është bërë me Vendimin nr. 42 datë 05.12.2014 të Kryesisë së Këshillit të Komunës, në kundërshtim me ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 me ndryshime, neni 29/1,2 pasi nuk është mbledhur Këshilli i Komunës për miratimin e fondit dhe numrit të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike, por është mbledhur dhe ka marrë vendim Kryesia e tij e përbërë nga: D.M., N. Ç., B. M. dhe N. Ll. fakt ky që vërtetohet me Protokollin e mbledhjes nr. 780, datë 31.12. 2014. Nga ky veprim është shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit në vlerën 9,000 lekë (3000+3000+3000 NE/muaj) (Trajtuar më hollësisht në faqet 67-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”* neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 *“Kodi i Procedurës administrative”* pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, Kapitulli IV *“Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve”* pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, në vlerën **9,000 lekë**, nga anëtarët e Kryesisë së Këshillit të Komunës Portëz-Fier, D.M., N. Ç., B. M. dhe N.

Ll. pasi kanë futur në skemën e ndihmës ekonomike tre familje me Vendimin nr. 42 datë 05.12.2014 të Kryesisë së Këshillit të Komunës, në kundërshtim me ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 pasi nuk është mbledhur më parë Këshilli i Komunës për miratimin e fondit dhe numrit të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike duke *shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit në vlerën 9,000 lekë.*

Menjëherë

-Nga verifikimi që ju bë dokumentacionit me zgjedhje dosjeve të përfituesve të ndihmës ekonomike në Komunën Portëz_Fier rezultoi se pesë familje, janë trajtuar në kundërshtim me VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së Ndihmës Ekonomike” kreu I, pika 2/ ç,d. Për pasojë buxhetit të shtetit i është krijuar *dëm ekonomik në vlerën 10, 000 lekë (Trajtuar më hollësisht në faqet 67-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për këtë është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, në vlerën **10,000 lekë**, nga Administratori Shoqëror, **P. R.** pasi nga verifikimi që ju bë dokumentacionit të përfituesve të ndihmës ekonomike në Komunën Portëz_Fier rezultoi se pesë familje, janë trajtuar në kundërshtim me VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së Ndihmës Ekonomike” kreu I, pika 2 duke sjellë buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën 10, 000 lekë.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 72/2, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 81, kreu XI, i është rekomanduar Agjencisë së Prokurimit Publik që në referim të nenit 58, të ligjit nr. 152/2013 “Statusi i nëpunësit civil”, datë 13.05.2013 dhe kreu II i VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, t’i kërkojë Autoritetit Kontraktor, Shërbimit Social Shtetëror (SH.S.SH), fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për personat si më poshtë:

1-E. **D.** me detyrë jurist, në rolin e anëtarit të komisionit të hartimit të dokumenteve të tenderit;

2-E. **H.** juriste me detyrë drejtore e Shërbimeve të Brendshme, në rolin e anëtares të komisionit të hartimit të dokumenteve të tenderit,

3-P. **D.** me detyrë ekonomiste e buxhetit, në rolin e anëtares të komisionit të hartimit të dokumenteve të tenderit;

4-E. **M.** me detyrë specialiste, në rolin e anëtares të komisionit të hartimit të dokumenteve të tenderit, (vetëm për tenderin me objekt “dezinfektimin e ambienteve”),
pasi;

1. Në procedurën e hapur për ruajtjen me roje private të SHSSH dhe institucioneve të varësisë, me fondin limit 6.990.000 lekë pa TVSH, në dokumentet e tenderit, në pjesën kushtet specifike, janë vendosur disa kërkesa të tepërta, të paargumentuara dhe të pabazuara në dokumentet standarde të tenderit, si;

-Për kapacitetin ligjor është kërkuar që shoqëria të ketë mbi 10 vjet aktivitet në fushën e ruajtjes e sigurisë, e vërtetuar me ekstraktin historik.

-Për kapacitetin ekonomik e financiar është kërkuar që shoqëria të ketë një kapital mbi 25 milion lekë, të deklaruar në ekstraktin e QKR.

Kërkesat e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 i ndryshuar, me Kreun III, pika 3/c të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*” i ndryshuar dhe me Dokumentet Standarde të Prokurimit. Këto kërkesa janë përjashtuese, sidomos për bizneset e vogla e të mesme dhe operatorët ekonomik që nuk i kanë plotësuar ato, duke i skualifikuar.

2. Në dokumentet e tenderit me objekt “*dezinfektimin e ambienteve (3 D-ve)*”, me fondin limit 972 mijë lekë, njësia e prokurimit nuk ka përcaktuar vlerën e kontratave të ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit, që sipas VKM nr. 1, date 10.01.2007 i ndryshuar, kreu III, pika 3/c, nuk duhet të jetë më e madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

-Për kapacitetin teknik, është kërkuar që operatori ofertues të disponojë minimalisht 1 (një) automjet në pronësi të shoqërisë me dokumentet përkatëse, kërkesë e pambështetur në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, pasi mjetet e pajisjet e kërkuara për realizimin e kontratës mund të jenë në pronësi ose të merren me qira me dokumentacion të rregullt.

-Lidhur me cilësinë e sigurinë e preparateve që do të ofrojnë operatorët ekonomik, në dokumentet e tenderit nuk është përcaktuar e mbështetur në tregues të efektit të preparateve, nuk është kërkuar certifikata apo licenca që duhet të paraqesin. Pra, nuk është vepruar në përputhje me kërkesën e përcaktuar në nenin 46/2 të Ligjit të Prokurimit Publik dhe Kreun III, pika 3/ç të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar.

-Nuk janë përcaktuar e klasifikuar sipërfaqja sipas ambienteve që do të dezinfektohen dhe llojet e preparateve që do të përdoren për trajtimin e tyre, ndarë në kategori.

3. Në tenderimin e një pjese të fondit prej 400 mijë lekë për ruajtjen me roje private, është përdorur procedura “*me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit*”, pa shpjeguar e argumentuar kushtet e nevojat ekstreme në të cilat është ndodhur autoriteti kontraktor, duke vepruar në kundërshtim me nenin 33, pika 2/c të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar.

5-E. B. specialiste e financës, në rolin e anëtares së komisionit të blerjeve me vlera të vogla për vitin 2014.

6-F. Gj. (ish specialist në SHSSH), në rolin e anëtares së komisionit të blerjeve me vlera të vogla për vitin 2014.

7-S. M. specialiste, në rolin e anëtares së komisionit të blerjeve me vlera të vogla për vitin 2014,

pasi;

a)nuk kanë zbatuar rregullat për mbajtjen e dokumentacionit të llogaritjes së fondit limit, nuk kanë përcaktuar të plotë e saktë specifikimet teknike të mallrave, shërbimeve që kërkohet të merren nëpërmjet këtyre procedurave.

b)Kanë skualifikuar ofertat me vlerë më të ulët, duke i trajtuar si oferta anomalisht të ulëta, duke vepruar në kundërshtim bazën ligjore të prokurimit, piken 2/c, kreu VI të VKM nr. 1,

date 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se vlerësimi për blerjet me vlera të vogla bëhet duke u bazuar në kriterin e çmimit më të ulët. Anëtarët e komisionit i drejtohen operatorit ekonomik, që ka ofruar çmimin më të ulët dhe bëjnë blerjen e mallrave, kryerjen e punëve ose të shërbimeve.

c) Në procedurën me objekt shërbimin printim/fotokopjim të 250 mijë dokumenteve për periudhën nga lidhja e kontratës deri më 31 dhjetor 2014, është ndryshuar objekti i kontratës, nga shërbim printim/fotokopjim në urdhrin e prokurimit dhe ftesën për ofertë, në dhënie me qira të pajisjeve të printim/fotokopjimit, në kontratë.

Në urdhrin e prokurimit dhe ftesën për ofertë, autoriteti kontraktor ka specifikuar që shërbimi printim/fotokopje, të ofrohet edhe në disa njësi të varësisë në Tiranë e rrethe. Në fakt shërbimi është kryer vetëm në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, duke lënë pa këtë shërbim njësitë e varësisë dhe degët në rrethe.

E. TË TJERA

Nisur nga auditimi shumë i dobët i realizuar në këtë mision, në mënyrë që të plotësohen gjetjet dhe të mbulohen të gjitha zonat me risk në këtë fushë aq sensitive edhe për opinionin publik, është rekomanduar që kjo periudhë të riauditohet nga KLSH-ja, në auditimin e radhës që do të ushtrohet në këtë subjekt, me objekt funksionimin dhe performancën e strukturave përgjegjëse në zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Alkida Llakaj përgjegjëse grupi, Benard Haka . Miranda Haxhia, Pranvera Doçi dhe Fadil Dekovi, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Departamentit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT